



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE PEJË

Numri i lëndës: 2019:262902

Datë: 30.09.2020

Numri i dokumentit: 01153303

PKR.nr.106/20

NË EMËR TË POPULLIT

GJYKATA THEMELORE NË PEJË-Departamenti për krime të rënda, sipas kryetares së trupit gjykues Violeta Husaj Rugova, me pjesëmarrjen e bashkëpunëtores profesionale Besa Dervishaj, në çështjen penale ndaj të akuzuarve G. K. nga, rruga “.....”, për vepër penale “Mbajta në pronësi, kontroll ose posedim të paautorizuar të armëve” nga neni 366 par.2 lidhur me par.1 të KPRK-së dhe A. V. nga, rruga “.....”, nr.43 për vepër penale “Mbajta në pronësi, kontroll ose posedim të paautorizuar të armëve” nga neni 366 par.1 të KPRK-së, duke vendosur sipas aktakuzës së Prokurorisë Themelore në Pejë, Departamenti për krime të rënda, PP/II.nr.2585/2019 të datës 07.02.2020, pas mbajtjes së shqyrtimit fillestar në prezencë të prokurorit të shtetit Valbona Disha Haxhosaj, të akuzuarit G. K. dhe mbrojtësi i tij me autorizim av.Nazmi Iberdemaj dhe i akuzuari A. V., me datë 21.09.2020 mori dhe shpalli si dhe me datë 30.09.2020 përpiloi këtë:

A K T G J Y K I M

Të akuzuarit:

1.G. K. i biri i R. dhe i nënës F. e gjinisë M., i lindur me datë, në, ku edhe jeton, rruga “.....”, nr.80, ka të kryer shkollën fillore, i martuar, punon si sigurim, i gjendjes së dobët ekonomike, i identifikuar në bazë të letërnjoftimit me nr....., me nr. të tel;, shqiptar, shtetas i Republikës së Kosovës, mbrohet në liri.

2.A. V. i biri i V. dhe i nënës S. e gjinisë M., i lindur me datë, në, me banim në, rruga “.....”, nr.43, ka të kryer shkollën e mesme, punon në mobilerin i martuar, i gjendjes së dobët ekonomike, i identifikuar në bazë të letërnjoftimit me nr....., me nr. të tel;, shqiptar, shtetas i Republikës së Kosovës, mbrohet në liri.

JANË FAJTOR

I akuzuari G. K.

Për shkak se:

-Me parë e gjerë me datë 11.11.2019, rreth orës 23:20, në rrugën “.....”, Komuna, i pandehuri në kundërshtim me nenin 5 par.1 të Ligjit për Armë (Ligji Nr.05/L-022) ka mbajtur në pronësi dhe kontroll dhe atë: një pushkë e gjatë automatike modeli i pa njohur, kal.7.62x 39mm, me numër serik 59110, dy karikator për pushkën automatike, 692 fishek kalibër 7.62x39 mm, 15 fishek 7.62x 25 mm, 10 fishek kal. NN, me gaz, një pistoletë, kal.

7.62x25mm, me numër serik 77503, një karikator për pistoletë dhe 6 fishek kalibër 7.62x25mm, në atë mënyrë që ditën kritike gjersa Policia e Kosovës, kanë kontrolluar-bastisur shtëpinë e të pandehurit, kanë gjetur dhe konfiskuar armën dhe municionin me të dhënat e lartcekura,

-Me çka ka kryer vepër penale, “Mbajta në pronësi, kontroll ose posedim të paautorizuar të armëve” nga neni 366 par.2 lidhur me par.1 të KPRK-së.

I akuzuari A. V.

Për shkak se:

-Që nga viti 2017 e gjerë para 11.11.2019, në rrugën “.....” teknë, i pandehuri në kundërshtim me nenin 5 par.1 të Ligjit për Armë (Ligji Nr.05/L-022) ka mbajtur në pronësi dhe kontroll një pistoletë me numër serik 77503, kal.7.62 mm, së bashku me një karikator, në atë mënyrë që ditën kritike gjersa policia e Kosovës kanë marr informata se i pandehuri A. V., posedon një pistoletë, me të kontaktuar, ky i fundit nga ana e policisë, i njëjti e pranon se ka në posedim një armë pa leje, e të cilën armë e ka tek shoku i tij G. K., ku më pas policia armën me të dhënat e lartcekura e kanë konfiskuar tek ky i fundit,

-Me çka ka kryer vepër penale, “Mbajta në pronësi, kontroll ose posedim të paautorizuar të armëve” nga neni 366 par.1 të KPRK-së.

Andaj gjykata duke u bazuar në nenin 7, 38, 40, 42, neni 43,44,69 të KPRK-së, nenit 366 par.2 lidhur me par.1 të KPRK-së, neni 366 par.1 të KPRK-së. si dhe nenit 365 të KPPK-së, të akuzuarit G. K. dhe A. V. i:

G J Y K O N

Ashtu që të akuzuarin **G. K.** i shqipton dënim me burgim në kohëzgjatje prej gjashtë (6) muajve.

I njëjti dënim me pëlqimin e të akuzuarit **G. K.** i zëvendësohet me dënim me gjobë në shumë prej 1200€ (njëmijë e dyqind euro), të cilin dënim është i obliguar që ta paguaj në afat prej tre (3) muajve, pas plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi.

Nëse i akuzuari i lartcekur dënimin me gjobë nuk e paguan në afat të caktuar, atëherë i njëjti do do të zëvendësohet në dënim me burgim duke ju llogaritur një ditë burg për çdo 20 euro të gjobës..

Obligohet i akuzuari që në emër të paushallit gjyqësor të paguaj shumën prej 25€, si dhe në emër të taksës për kompensimin e viktimave të krimit në shumë prej 50€, të gjitha këto në afat prej 15 ditësh, pas plotfuqishmërisë së aktgjykimit.

Të akuzuarit **A. V.** i shqipton dënim me gjobë në shumë prej 400€ (katërqind euro), të cilin dënim është i obliguar që ta paguaj në afat prej 3 (tre) muaj, pas plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi.

Nëse i akuzuari i lartcekur dënimin nuk e paguan në afat të caktuar, atëherë dënimi me gjobë gjykata do ta zëvendësoi me dënim burgu, duke llogaritur një ditë burgim për çdo 20 euro të gjobës.

Obligohet i akuzuari që në emër të paushallit gjyqësor t'ia paguaj Gjykatës shumën prej 25€, si dhe në emër të taksës për kompensimin e viktimave të krimit në shumë prej 50€, të gjitha këto në afat prej 15 ditësh, pas plotfuqishmërisë së aktgjykimit.

Të akuzuarve konform nenit 366 par.3 të KPRK-së, iu konfiskohen: një pushkë e gjatë automatike modeli i pa njohur, kal.7.62x 39mm, me numër serik 59110, dy karikator për pushkën automatike, 692 fishek kalibër 7.62x39 mm, 15 fishek 7.62x 25 mm, 10 fishek kal. NN, me gaz, një pistoletë, kal. 7.62x25mm, me numër serik 77503, një karikator për pistoletë dhe 6 fishek kalibër 7.62x25mm, si dhe një pistoletë me numër serik 77503, kal.7.62 mm, së bashku me një karikator, të cilat armë do të shkatërrohen pas plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi.

A r s y e t i m

Prokuroria Themelore në Pejë, departamenti për krime të rënda, ka ngrit aktakuzë PP/II.nr.2585/2019 të datës 07.02.2020, ndaj të akuzuarve G. K. nga, rruga “.....”, për veprë penale “Mbajta në pronësi, kontroll ose posedim të paautorizuar të armëve” nga neni 366 par.2 lidhur me par.1 të KPRK-së dhe A. V. nga, rruga “.....”, nr.43 për veprë penale “Mbajta në pronësi, kontroll ose posedim të paautorizuar të armëve” nga neni 366 par.1 të KPRK-së.

Gjykata ka caktuar shqyrtimin fillestarë me datë 21.09.2020, Pas leximit të aktakuzës nga ana e Prokurorit të shtetit PP/II.nr.2585/2019 të datës 07.02.2020, në seancën e shqyrtimit fillestar, gjykata është bindur se të akuzuarit e kanë kuptuar aktakuzën dhe të akuzuarve iu ka dhënë mundësinë që të deklarohen për pranimin ose mos pranimin e fajësisë.

Në këtë rast gjykata ka udhëzuar të akuzuarit për rendësin dhe pasojat e pranimit të fajësisë dhe i akuzuari G. K. ka deklaruar se i ka kuptuar pasojat dhe përparësitë e pranimit të fajësisë të cilat i janë shpjeguar nga ana e Gjykatës dhe pas konsultimit me mbrojtësin e tij, deklaron se e pranon fajësinë për veprën penale e cila i vihet në barrë.

I akuzuari A. V., ka deklaruar se i ka kuptuar pasojat dhe përparësitë e pranimit të fajësisë të cilat i janë shpjeguar nga ana e Gjykatës, deklaron se e pranon fajësinë për veprën penale e cila i vihet në barrë, pendohet nuk ka diçka për të shtuar, i vjen keq çfarë ka ndodhur.

Prokurori i shtetit ka deklaruar se pajtohet me pranimin e fajësisë të bërë nga ana e të akuzuarve, i njëjti pranim ka mbështetje në provat që gjenden në shkresat e lëndës, i propozon Gjykatës që të aprovohet pranimi i fajësisë

Mbrojtësi i të akuzuarit G. K., av. Nazmi Iberdemaj ka deklaruar se pajtohet me pranimin e fajësisë nga ana e të mbrojturit të ti dhe është konsultuar mjaftueshëm me të.

Në vijim gjykata duke shqyrtuar fajësinë nga ana e të akuzuarve vlerësoi se pranimi i fajësisë paraqet shprehje të lirë të vullnetit të akuzuarve të lartcekur, pasi që ata e kanë kuptuar natyrën dhe pasojat e pranimit të fajësisë.

Duke pasur parasysh të lartcekurat gjykata e ka aprovuar pranimin e fajësisë nga ana e të akuzuarve dhe ka vërtetuar se nuk ekziston ndonjë rrethanë për hudhje të aktakuzës konform nenit 253 të KPPK-së, se janë plotësuar kushtet nga neni 248 të KPPK-së, atëherë në këtë çështje nuk është zbatuar procedura e provave, por gjykata ka vazhduar me shqiptimin e dënimit.

Andaj gjykata duke u gjendur para këtyre fakteve siç janë pranimi i fajësisë nga ana e të akuzuarve, si dhe duke pasur parasysh provat të cilat gjenden në shkresat e lëndës siç janë: raporti fillestar i incidentit me nr. të rastit 2019-DA-2319 i datës 12.11.2019, raporti i policit D. B. i datës 12.11.2019, deklarata e të pandehurit G. K. e dhënë në polici dhe në prokurori, deklarata e të pandehurit A. V. e dhënë në polici dhe në prokurori, deklarata e dëshmitarit A. Sh. e dhënë në polici me dt. 11.11.2019, lista e armëve të konfiskuara e dt. 11.11.2019, raport i datës 12.11.2019, procesverbal mbi bastisjen e banesës dhe personave 11.11.2019, lista e armëve të konfiskuara e dt. 11.11.2019, gjykata erdhi në përfundim se në veprimet e të akuzuarve ekzistojnë të gjitha elementet e veprave penale të përshkruara si në dispozitiv të këtij aktgjykimi e për të cilin janë shpallur fajtor.

Duke vendosur mbi vendimin mbi dënim konform nenit 69 të KPRK-së, gjykata i vlerësoi të gjitha rrethanat lehtësuese dhe rënduese që ndikojnë në llojin e dënimit dhe nga rrethanat lehtësuese gjeti se e ka pranuar fajësinë qysh në fillim, patën sjellje korrekte në shqyrtim fillestar, janë penduar, për gjykatën nuk ka të dhëna se të njëjtit kanë ra ndesh me ligjin më parë, ndërkaq nga rrethanat rënduese për të akuzuarit e lartcekur gjykata nuk ka gjeje asgjë.

Andaj gjykata duke u gjendur para këtyre rrethanave të akuzuarit i gjykoi si në dispozitiv të këtij aktgjykimi duke konsideruar se ky dënim është në përputhje me shkallën e përgjegjësisë penale të tij dhe me intensitetin e rrezikimit të vlerave të mbrojtura të shoqërisë dhe është bindur se vendimi mbi dënimin do të shërbej për arritjen e qëllimit të dënimit e që është pengimi i të akuzuarit në kryerjen e veprave penale në të ardhmen si dhe në preventivën tjetër për personat tjerë që të përmbahen nga kryerja e veprave penale konform nenit 38 të KPRK-së.

Duke u bazuar në nenin 450 të KPRK-së, e obligoi të akuzuarit e lartcekur veq e veq që ti paguajn shpenzimet e paushallit gjyqësor.

Konform nenit 39 par.1,2,3 nën par. 3.1 të Ligjit për kompensim të viktimave të krimit e obligoi të akuzuarit e lartcekur veq e veq që ti paguaj shpenzimet e viktimave të krimit.

Konform nenit 366 par.3 të KPRK-së, konfiskohet një pushkë e gjatë automatike modeli i pa njohur, kal.7.62x 39mm, me numër serik 59110, dy karikator për pushkën automatike, 692 fishek kalibër 7.62x39 mm, 15 fishek 7.62x 25 mm, 10 fishek kal. NN, me gaz, një pistoletë, kal. 7.62x25mm, me numër serik 77503, një karikator për pistoletë dhe 6 fishek kalibër 7.62x25mm, si dhe një pistoletë me numër serik 77503, kal.7.62 mm, së bashku me një karikator, të cilat armë do të shkatërrohen pas plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi.

Nga sa u tha më lart u vendos si në dispozitiv të këtij aktgjykimi konform nenit 365 të KPPK-së.

**GJYKATA THEMELORE PEJË
DEPARTAMENTI I KRIMEVE TË RËNDA ,**

2019:262902, 30.09.2020

Kryetarja e turpit gjykues

Violeta Husaj Rugova

KËSHILLË JURIDIKE: Kundër këtij aktgjykimi është e lejuar ankesa në afat prej 15 (pesëmbëdhjetë) ditëve nga koha e pranimin të të njëjtit, Gjykatës së Apelit në Prishtinë, nëpërmjet kësaj Gjykate Themelore.